



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2298/1 Prot.

Tiranë, më 21.08.2026

Lënda: Kërkesë për hapjen e shërbimit online

AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
*Adresa: Rruga Papa Gjon Pali II 3,
Tiranë*

Për dijeni: MINISTRISË SË ARSIMIT

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.23, Tiranë

Në zbatim të shkresës nr. 2298, datë 21.08.2026, "Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin shkollor 2026-2027", kërkojmë nga ju hapjen e shërbimit online për aplikimin e kandidatëve që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit pranë institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar. Duke qenë se, në urdhrin e MAS nr. 100, datë 25.02.2022, "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit'", i ndryshuar, kohëzgjatja e praktikës profesionale është një periudhë mësimore, duhet që shërbimi për aplikimin online të jetë i aksesueshëm nga kandidatët sipas periudhave:

- Për periudhën e parë mësimore: nga data 26.08.2026 deri më 04.09.2026
- Për periudhën e dytë mësimore: nga data 01.12.2026 deri më 13.12.2026
- Për periudhën e tretë mësimore: nga data 01.03.2027 deri më 14.03.2027

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Arta DOLLANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
Irida Shulku
ZV/ DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu"
AL 1001, Tiranë

website: www.arsimiparauniversitar.gov.al